

# Reflektimi teologjik

Reflektimi teologjik është përshkruar si:

"një proces që mbledh intuitat të nxjerra nga përvojat, nga kulturat dhe nga traditat tona teologjike dhe na çon në një veprim të menjëhershëm"<sup>49</sup>

Reflektimet e mëposhtme shërbejnë për të eksploruar traditën tonë teologjike, ku gjejmë burime të pasura që:

- Nxisin dinjitetin e gruas.
- Njohin seksualitetin njerëzor si dhuratë.
- Dënojnë shfrytëzimin dhe skllavërinë.
- Kërkojnë respektin reciprok në marrëdhënien mes burrit dhe gruas.
- Na ftojnë të angazhohemi për çlirimin e atyre që janë skllavër.

Vazhdimi i reflektimit mbi secilën prej seksioneve të mëposhtme:

1. Imagjinoni sikur takoni një grua viktimë të trafikimit... uleni me të, flisni me të, zbuloni se si ndihet... më pas shënoni ndjenjat dhe mendimet e juaja.
2. Lexoni dhe reflektoni mbi njëërën prej seksioneve që ndjekin mëposhtë.
3. Cilat janë reagimet e juaja mbi atë që keni lexuar dhe cila është arsyeja e tyre?
4. A njihni teologe që në këtë moment shkruajnë mbi temën e grave dhe dhunës? Mund të reflektoni mbi atë që thonë?<sup>50</sup>
5. Në çfarë mënyre jeni thirrur të veproni?



<sup>49</sup> School Sisters of Notre Dame, *Trafficking*, Shalom North America, March 2002, p.1.

<sup>50</sup> Për shembull: Mary John Mananzan, Mary Grey, Elsa Tamez, Letty Russell, *Women Resisting Violence: Spirituality for Life*, Orbis Books, New York, 1996

## **A.- Reflektimi në funeralin e Tina Motoc**

(Reflektim i shkruar nga Motër Eugenia, Misionare e Ngushëllueses, për Tinan, një njëzetë vjeçare rumune, viktimë e trafikimit, e çuar në Itali dhe që është gjetur e vvarë në një rrugë në afërsi të Torinos në shkurt të 2001).

Tina, na dhuro faljen tënde

Tina e dashur,

Gjendemi të mbledhura në këtë kishë për të të dhënë përshëndetjen e fundit para se trupi yt të kthehet në Atdheun tënd. Në këtë moment do të doja t'u jepja zë shumë personave, të pranishëm dhe që mungojnë. Së bashku duam të të kërkojmë të falur për përgjegjësitë tona vetjake dhe kolektive. Jeta jote e re e thyer trembëdhjetë muaj më parë na peshon rëndë në ndërgjegje dhe e ndiejmë të nevojshme të falemi nga ti dhe të nxitemi të luftojmë kundër të gjitha formave të skllavërisë dhe shfrytëzimit.

- I kërkojmë të falur vajzës tënde të vogël Elisa, që ke lënë në Rumani pak muaj pas lindjes: i kërkojmë të falur mamasë tënde dhe të gjitha mamave që qajnë me qindra vajza që kanë ardhur në Itali me shpresën për një jetë plot shpresë dhe të goditura nga një vdekje e tmerrshme dhe përlulëse si kjo e jotja.
- Tina, fale hipokrizinë e shoqërisë sonë të mirëqenies dhe konsumit, që tregon zhvillim dhe përparim teknologjik, por që ka harruar respektin për dinjitetin dhe shenjtërinë e çdo personi.
- Fale mosdërrhyrjen e autoriteteve tona civile që lejojnë ose tolerojnë këtë skllavëri të re të 2000 dhe nuk duan të mundin racket dhe organizatat e trafikantëve e qenieve njerëzore, duke bërë që jeta e mijëra të rejave të pambrojtura të shkatërrohet nga interesat e urryera ose nga fitimet e ulëta.
- Fali forcat e rregullit që nuk të kanë mbrojtur dhe ruajtur, sepse ishe klandestine, pa dinjitet dhe e vjedhur edhe nga dinjiteti dhe liria jote.
- Fali, ata, që çdo natë, të kërkonin, të përdhunonin, të përdornin si objekt pëlqimi, dhe që më pas të hidhnin në rrugë si mbeturinë, duke bashkëpunuar me ruajtësit e tu dhe duke u shtuar atyre fitimin, duke paguar një tarifë që ishte caktuar për të mbështetur kriminalitetin e organizuar.
- Fali autoritetet fetare që nuk kanë ditur të bërtasin aq sa duhet dhimbjen tënde dhe që nuk kanë denoncuar padrejtësinë e shfrytëzimit tënd dhe të skllavërisë tënde. Gjatë Vitit të Shenjtë të Jubileut të Madh, ke pritur më kot që të thyeshin zinxhirët e tu dhe që të vërtetohej për ty dhe për të gjitha shoqet e tua të rrugës "Viti i hirit dhe i mëshirës së Zotit" (Lk. 4,19).
- Fale sjelljen e shumë të krishterëve që të kanë gjykuar dhe dënuar, sepse bezdisje ashtu si gruaja kurorëthyesë e Ungjillit, njosje rrugët tona dhe përlulje turpin tonë të rremë.
- Të kërkoj të falur, në emër të të gjitha ne grave, sepse me indiferentizëm dhe heshtje nuk kemi dëgjuar thirrjen tënde të dhimbjes dhe të kemi lënë "vetëm" në rrugë, të jetoje dramën e vetmisë tënde, të përçmimit, të ankthit dhe të frikës.
- Të kërkoj të falur, Tina, edhe në emër të vrasësit tënd, që ka vvarë trupin tënd të ri. Por ai nuk është vetëm përgjegjës për vdekjen tënde: në fakt, para se të goditeshe, ti ishe e vdekur. Sa persona kanë vvarë ëndrrat e tua dhe pritjet e 20 vjetëve të tu! Për këtë vdekje ndihemi të gjithë fajtorë dhe bashkëpërgjegjës: për këtë thërrasim mëshirën e Hyjit.

Tani dëshirojmë për ty pushimin në paqe dhe në dashurinë e atij Hyji që është Atë i të gjithë të lënëve mënjane, të përlurve dhe përçmuarve të historisë, sepse Ai: "I ka hequr të fuqishmit nga fronet dhe ka ngritur të përvuajturit"; Ai "Ka mbushur me të mira të uriturit dhe ka dërguar të pasurit duarbobsh" (Lk. 2,52-53). Ai të thaftë tani të gjitha lotët dhe të dhuroftë gëzimin e paqes dhe të jetës së amshuar. Elizës së vogël, që ka mbetur jetime, dhe familjarëve të tu, t'u arrijë ngushëllimi i lutjes sonë, solidariteti dhe bashkëndarja për angazhimin për të mbrojtur dhe çliruar të gjitha skllavet e shekullit të njëzetëenjë.

Amen!

(Famullia e Jezusit Shëlbues, Torino,  
23 mars 2002 – dita e funeralit të saj)

## **B. - Besëlidhja e Vjetër dhe shtypja**

Sipas Elsa Tamez, në Besëlidhjen e Vjetër ka 9 fjalë të ndryshme që shprehin lloje të ndryshme "shtypjeje".<sup>51</sup> Duke reflektuar mbi situatën e grave dhe të fëmijëve viktimë të trafikimit, duket sikur këto vuajnë, nëse jo të gjithë, të paktën pjesën më të madhe të llojeve të ndryshme të shtypjes, meqë trafikimi është "një ofendim tronditës ndaj dinjitetit njerëzor dhe një dhunim i rëndë i të drejtave njerëzore themelore" (Gjon Pali i II). Ndërsa lexoni dhe meditonit referimet në Besëlidhjen e Vjetër, kujtoni historitë e grave që janë shfrytëzuar në këtë botë:

- ANAH: do të thotë "shtypje, shfrytëzim, përrulje, poshtërim; nënshtrim, sundim; trishtim, ankth; detyrim ose përdhunim gruaje". Zan. 15:13; Dalja 3:7; 2 Sam 13:12-14, Psalmi 119:107.
- ASHAQ: do të thotë "shtypje, të marrit me forcë ose rrëmbim". Pr. 14,31; 28:3; Ez. 22:7-12; Eccle 5:8; Jer 22; 3.
- LAHATS: do të thotë "shtypje; të bërit presion, sundim ose asgjësim; ngacmim, refuzim ose mbyllje". Dal 3:9; Dt. 26:7; Iz. 19:20; Am 6:14.
- NAGASH: do të thotë "sundim, shfrytëzim, forcim, të bërit presion". Dal. 5:6; 10:14; Gb. 39:7.
- YANAH: do të thotë "shtypje, shfrytëzim, sundim në mënyrë brutale, nënshtrim, të dhënit fund, grabitje, mashtrim, gënjim". Zp. 3:1; Ez. 22:3; 22:6; 22:25-26; 22:29.
- RATSATS: do të thotë "të shkelurit me këmbë, të shtypurit me këmbë dhe copëtim". Jer. 22:17; Gb 20:19; Is. 36:6; Jg. 9:53, Ps. 74:14.
- DAKA: do të thotë "shkatërrim, pluhurizim dhe thyerje". Ps. 72,4; 85:11; 94,5; Jer. 44,10; Is. 19,10; 57,1; Gb. 34,25.
- DAK: do të thotë "dërrmim, shtypje, mundim". Ps. 9,9; 10,12; 10, 17-18; 74.
- TOK: do të thotë "shtypje dhe tirani". Ps. 55,11; Pr. 10,7; 55,11.

### ***C. - Jezusi dhe prostitutat***

Janë të denja disa gra që, të caktuara si prostituta si në Besëlidhjen e Vjetër ashtu edhe në Besëlidhjen e Re, kujtohen me mirësi. Njëra prej tyre, Rahab, kishte pranuar dhe fshehur spiunët e dërguar nga Jozue për të eksploruar tokën e premtuar (Jz. 2,1-21). Me aktin e tij të mirësjelljes synonte që të fitonte shpëtimin për vetveten dhe për familjen e tij kur Izraelianët do të shkatërronin Jerikon (Jz. 6, 22-25). Më pas qe prostituta e "mirë", që kishte lejuar që shoqja e saj të merrte fëmijën e saj, se sa ta linte të pritej në dy pjesë siç kishte urdhëruar Mbreti Salomon (1 Mbretërit 3, 16-28). Profetit Osea Hyji i urdhëroi "Shko, merr për grua një prostitutë dhe ki fëmijë prostituimi" si shenjë për kombin izraelian (Os 1, 2-9; 3, 1-3).

Në Besëlidhje e Re hasim një grua samaritane, që kishte qenë martuar me pesë burra përpara se të jetonte me një që nuk ishte burri i saj (Gjn. 4,18). Jezusi e bëri "apostull" të Samarisë. Më pas qe mëkatarja, që i lau këmbët Jezusit dhe i leu kokën me vaj erëmirë. Jezusi tha se ajo kishte dashur shumë dhe për këtë i ishin falur mëkatet (Lk. 7, 36-50). Më pas qe grua kurorëthyesë që Jezusi e shpëtoi nga vrasja me gurë nga ana e farisenjve dhe e skribëve. Jezusi nuk e dënoi, por i tha: "Shko dhe tash e tutje mos mëkato më" (Gjn. 8, 1-11).

(Për të RIVENDOSUR DINJITETIN E GRUAS NIGERIANE – Letra Baritore e Konferencës Ipeshkvnore të Ipeshkvijve Katolikë të Nigerisë).

### ***D. - Dinjiteti i Gruas: nga mësimi social katolik dhe nga letrat e Gjon Palit të II-të***

#### ***Gaudium et Spes***

Koncili i II-të i Vatikanit ankohej për faktin që të drejtat themelore të gruas nuk respektoheshin në mbarë botën:

Ndodh kështu kur një grua i mohohet mundësia për të zgjedhur lirisht një burrë dhe për të bërë një zgjedhje jete, ose për t'ju afruar një edukimi dhe një kulture të barabartë që i lejohet burrave (Kushtetuta baritore mbi Kishën në botën bashkëkohore, Gaudium et Spes n. 29).

#### ***Mulieris Dignitatem***

Gjon Pali i II-të në thirrjen e tij apostolike *Mulieris Dignitatem* (Mbi dinjitetin femëror, 1988) ka thënë se...

... Kisha dëshiron të falënderojë Trininë e Shenjtë për "misterin e gruas", dhe, për çdo grua – për atë që përbën masën e amshuar të dinjitetit të saj femëror, për "veprat e mëdha të Hyjit" që në historinë e brezave njerëzore janë përmbushur në të dhe përmes saj (n. 31).

## Letër drejtuar grave (1995)

Në një Letër drejtuar grave (1995), Gjon Pali i II-të ka shkruar:

Dinjiteti i grave shpesh nuk është i njohur, dhe cilësitë e tyre janë lënë pas dore; shpesh ato janë lënë mënjanë në shoqëri, dhe madje edhe të kthyer në skllave. Kjo i ka ndaluar gratë që të jenë vetvetja dhe ka shkaktuar varfërimin shpirtëror të njerëzimit (n. 3).

### Konferenca Ndërkombëtare mbi Trafikimin: Letra e Gjon Palit të II-të

Në një letër të vonëshme drejtuar Arqipeshkëvit Jean Louis Tauran, me rastin e Konferencës Ndërkombëtare "Skllavërimi i shekullit XXI: përmasa e të drejtave njerëzore në trafikimin e personave", Papa Gjon Pali i II-të ka thënë:

*Tregtia e personave njerëzorë përbën një fyerje ndaj dinjitetit njerëzor dhe një dhunim të rëndë të të drejtave të personit njerëzor. Koncili i II-të i Vatikanit kishte përcaktuar "të turpshme" skllavërinë, prostituimin, tregtimin e grave dhe të rejave, ose akoma poshtëruese kushtet e punës me të cilat punëtorët janë trajtuar si mjete të thjeshta fitimi, dhe jo si persona të lirë dhe përgjegjës" dhe se "ndërsa prishin qytetërimin njerëzor, akoma më tepër ndotin ata që sillen kështu... dhe fyejnë rëndë nderin e Krijuesit" (Gaudium et Spes n. 27). Këto situata janë një përballje me vlerat themelore të bashkëndara nga të gjitha kulturat dhe nga të gjithë popujt, vlera të rrënjësura në vetë natyrën e personit njerëzor.*

### LUTJA PËR PËRFUNDIMIN E TRAFIKIMIT

O Hyj, fjalët tona nuk mund ta shprehin  
atë që mendjet tona mund të kuptojnë  
dhe atë që miratojnë zemrat tona  
kur marrim vesh për gratë dhe vajzat që janë mashtruar dhe  
çuar në vende të panjohura  
për qëllime shfrytëzimi dhe abuzimi seksual  
të shkaktuara nga lakmia njerëzore dhe nga përfitimet.  
Tani, në botën tonë  
zemrat tona të trishtuara, shpirtrat tanë të indinjuar  
sepse dinjiteti dhe të drejtat e atyre personave dhunohen me anë të kërcënimeve,  
me mashtrim dhe me forcë.  
Ne e ngremë thirrjen tonë kundër trafikimit poshtërues  
dhe lutemi që të mund të mbarojë.  
Forcoji ata që janë të brishtë në shpirt  
dhe ata që kanë zemrën e thyer.  
Bëj që të përmbushen premtimet e tua  
që të mbushë me dashuri dhe butësi këto motrat tona  
dhe t'i dërgosh duarbosh shfrytëzuesit.  
Na dhuro diturinë dhe kurajën  
për të qenë solidarë me to  
deri sa së bashku të mund të gjejmë rrugët e lirisë,  
që është dhurata jote për ne të gjithë.<sup>52</sup>

---

<sup>52</sup> SSND Trafficking Reflection Booklet. Canadian Province, p.10

## Pyetje për laboratorin

- \* Si mund ta zhvillojmë një përshpirtëri jete që të arrijë t'i kundërvihet dhunës mbi gra dhe fëmijë?
- \* Si mund të shërohet dhe rigjehet integriteti i atij që ka qenë shitur dhe trafikuar sikur të ishte një mall?
- \* Si mund të kalojnë gratë nga një pamje tepër e ngushtë e të qenit viktimë dhe e dhunës në një perspektivë të re force dhe fitimi fuqie?
- \* Si mund të përballen me errësitat e shfrytëzimit dhe të skllavërisë dhe si mund të ftohen ata burra e gra që janë përfshirë në xhiron e trafikimit që të ndryshojnë jetë?
- \* Si mund të ndryshojnë marrëdhëniet mes dy sekseve në mënyrë që gratë të trajtohen me dinjitet?

### ***D. - Strategjitë për kongregatat rregulltare dhe për bashkëpunëtorët e tyre***

Trafikimi i grave dhe i fëmijëve është një problem me përmasa botërore që kërkon një zgjidhje të menjëhershme dhe të hartuar mirë. Një shqyrtim i plotë i aspekteve të ndryshme të trafikimit është i rëndësishëm për të identifikuar përmasat politike, ekonomike, sociale, ligjore dhe institucionale të fenomenit. Ndërveprimi i agjentëve të ndryshëm, dhe në nivele të ndryshme, është vendimtar për të luftuar trafikimin.

Ja disa hapa që duhen bërë së bashku me persona të tjerë. Si rregulltarë kemi mundësinë që të përfshihemi në veprimin e drejtëpërdrejtë me viktimat e trafikimit, në programet e edukimit parandalues, në programet e rihabilitimit, në kërkimin dhe në ushtrimin e presioneve politike. Kur kongregatat rregulltare bashkëpunojnë në nivel ndërkombëtar në laboratorët dhe në grupet e punës, ato mund të venë së bashku në mënyrë efektive burimet e tyre dhe kompetencën e tyre, dhe të bëhen mbartës të ndryshimeve.

#### **1. Kërkimi, mbledhja e të dhënave, përhapja e informacioneve**

- Të mbledhen të dhënat mbi trafikun është baza për një plan veprimi efikas dhe për formulimin e një programi (të dhënat e kërkimit duhet të jenë të ndara sipas seksit dhe moshës).
- Të përgatitet një listë e organizatave kombëtare dhe krahinore që merren me trafikimin.
- Të përhapen të dhënat dhe informacionet në gjuhë të ndryshme kombëtare.
- Të përbëhet një grup kërkimi ndërdisiplinor.
- Të krijohen lidhje mes universiteteve dhe personave që "punojnë në terren", mes organizatave dhe individëve të përfshirë në peripecitë e përditshme të atyre që janë vulnerabël ndaj trafikimit.
- Të përdoret kuadri i të drejtave njerëzore për të dokumentuar abuzimin e të drejtave njerëzore të lidhur me trafikimin e grave dhe të fëmijëve.

#### **2. Shtimi dhe mbështetja e sensibilizimit**

- Të organizohen fushata sensibilizimi mbi trafikimin në nivel vendor, kombëtar dhe krahinor për të mobilizuar grupe të ndryshme: duke u nisur nga gratë dhe fëmijët deri tek ata që marrin vendime politike, në organizatat qeveritare dhe jo qeveritare, tek kongregatat rregulltare dhe tek entet kishitare.
- Të shtohet sensibilizimi mbi sistemet anësore: agjencitë që gjejnë shoqëruarit, industria e turizmit, rretet e prostitucionit, prostitucioni i drejtëpërdrejtë i ushtrisë.

- Të përdoren në mënyrë strategjike mediat për të garantuar një trajtim më të gjerë të problemit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, për të krijuar një opinion politik për të ndaluar trafikimin.
- Të fuqizohet angazhimi për të mbështetur çështjen, dhe të futet një përbërës i fortë sensibilizimi mbi çështjet që u përkasin grave dhe vajzave.
- Të nxisin reflektimin dhe diskutimin teologjik, në brendësi të kishave dhe famullive, mbi ekzistencën e padyshimtë të "blerësve" shërbimeve seksuale, dhe mbi implikimet e këtij fakti për bashkësinë e burrave dhe grave në kishë.
- Të nxitet intoleranca sociale kundrejt atij dhunimi të të drejtave njerëzore të quajtur prostitucion.
- Të integrohet trajtimi i drejtësisë ekonomike dhe barazia e llojit në programet e studimeve.
- Të zbulohen se cilat organizata në zonën tuaj merren me trafikimin dhe bashkohuni me to.
- Kërkoni tek shkolla juaj, në famullinë tuaj dhe në shërbimin tuaj social që ta thelloni këtë problem në mënyrë që të vini re se çfarë mund të bëhet.

### **3. Parandalimi**

- Të dallohen shkaqet që janë si bazë e varfërisë, të përmirësohet mundësia për të përfituar nga arsimit dhe nga mundësitë punësuese, dhe sidomos mundësitë e hyrjes së grave në burimet prodhuese.
- Të nxitet në veçanti edukimi i burrave dhe të rinjve mbi trafikimin e grave dhe vajzave dhe mbi efektet e saj çnjerëzore.
- Të ofrohen rrugë reflektimi teologjik mbi dinjitetin e grave dhe feminitetit dhe mbi planin e Hyjit sipas të cilit burrat dhe gratë duhet të jetojnë marrëdhënie ndërvetjake.

### **4. Mbrojtja, kthimi dhe reintegrimi**

- Ndihma fizike, ekonomike, ligjore, psikologjike dhe ligjore për gratë viktime të trafikimit.
- Lehtësime për formimin punësues dhe mbështetja e mjeteve alternative të jetesës.
- Programet e riabilitimit dhe reintegrimit në shoqëri.
- Ndihma për familjet e viktimave.

### **5. Mbështetja e qeverive dhe presionet politike**

- Të përforcohet dhe vihet në praktikë Konventa Ndërkombëtare për të nxitur dhe mbrojtur të drejtat e grave dhe fëmijëve viktime të trafikimit.
- Të rishihet, përmirësohet dhe vihet në praktikë një legjislacion i përshtatshëm në nivel kombëtar.
- Të rishihen ligjet për imigrimin me qëllimin që të parandalohet trafikimi.
- Të shpejtohet formimi i organizmave për aplikimin e ligjeve dhe të personelit, duke përfshirë sensibilizimin në përgjithësi.
- Të fuqizohen mekanizmat për aplikimin e ligjeve dhe të mundohet që shkelësit e ligjeve të ndiqen penalisht.
- Të nxitet njohja e ligjeve dhe të përmirësohet mundësia për të patur një ndihmë ligjore.
- Të përmirësohet trajtimi rezervuar ndaj viktimave të trafikimit.
- Të zhvillohen orientimet e programeve të reintegrimit shumë disiplinor (për shembull kujdesi ndaj shëndetit, orientimi, arsimit dhe formimi, integrimi social).

### **6. Krijimi i rrjetave të ndërveprimit**

- Të krijohet një rrjetë efikase ndërveprimi mes kongregatave mbi problemin e trafikimit.
- Të krijohen rrjeta me OJQ dhe me organizatat në nivel vendor, kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Të bashkëpunohet me Kishat e tjera dhe me besimet e tjera fetare.

## Pyetje për laboratorin

1. Cili është ndikimi i mediave dhe i reklamave mbi idenë tonë të trupit femëror?
  2. Si mund të kundërshtojmë normalizimin dhe globalizimin e seksit të propozuar nga mediat?
  3. Si mund t'i shndërrojë shoqëria gratë në objekte dhe në mall që duhet shitur ose blerë?
  4. Si mund të "sfidohen" burrat, klientët që "blejnë" gratë?
- 
5. Nga ku do të filloni?
  6. Çfarë hapash mund të bëni për t'i qëndruar besnikë karizmës?
  7. Cila është pikëpamja morale e Kishës? Cilat janë mësimet e saj dhe predikimet e saj në lidhje me këtë problem?
  8. Si mendoni t'i krijoni rrjetat efikase dhe jetësore me anëtarët e kongregatave të tjera rregulltare dhe me realitetet e tjera?

## **E. - Deklaratat e UISG**

Deklarata që ndjek më pas është përpunuar nga Bashkimi Ndërkombëtar i Eprorëve të Përgjithshëm, që paraqet më shumë se 800 kongregata rregulltare me 1.000.000 anëtarë.

**Deklarata e qëllimeve të Rregulltareve  
Anëtarë të Bashkimit Ndërkombëtar të Eprorëve të Përgjithshme  
Pjesëmarrëse në Mbledhjen Plenare të UISG, të mbajtur në Romë, 6-10 maj 2001,  
dhe Përpunuar nga Ansamblea e Delegateve më 13 maj 2001**

Jemi rreth 800 Eprorë të Përgjithshme që përfaqësojnë një milion anëtarë të kongregatave katolike në të gjithë botën.

Pasi u reflektua mbi temën:

**Rregulltare: shumë kultura – një zemër të vetme:**

**të dërguara për të qenë një prani e gjallë e butësisë dhe mëshirës së Hyjit  
në botën tonë të vuajtur,  
deklarojmë publikisht vendimin tonë për të punuar së bashku në solidaritet**

në bashkësitë tona rregulltare dhe në vendet ku veprojmë  
**për të denoncuar me këmbëngulje, në çdo nivel,  
abuzimin seksual dhe shfrytëzimin e grave dhe fëmijëve**  
me një vëmendje të veçantë ndaj  
**trafikimit të grave**  
që është kthyer në një treg fitimprurës shumëkombësh.

Në pragun e traditës sonë të gjatë edukuese  
**do të vazhdojmë të nxisim edukimin dhe formimin e grave,**  
brenda dhe jashtë instituteve tona,  
duke u angazhuar personalisht dhe me burime financiare  
për të siguruar zhvillimin integral të grave në çdo fazë të jetës,  
duke i ndihmuar që të fuqizojnë forcën e tyre të brendshme dhe vlerësimin e dhuratave të marra nga  
Hyji për të nxitur dhe mbrojtur jetën.

Ne gratë, të angazhuara për të mbrojtur të drejtat njerëzore,  
**deklarojmë edhe një herë solidaritetin tonë me vendet më të varfëra  
dhe sigurojmë angazhimin tonë për të punuar  
për heqjen e borxhit ndërkombëtar.**

Ne gratë që i kundërvihemi konflikteve të vazhdueshme, dhunave dhe luftrave,  
**shprehim angazhimin tonë për të nxitur një kulturë paqeje**  
dhe i apelohe mi përgjegjësve të qeverive dhe organizatave shumëkombëshe  
**që të pushojnë hakmarrjen dhe blerjen e armëve.**

Ne gratë të kushtura mbrojtjes së Nënës tonë Tokë,  
do të mundohemi, kur dhe ku të jetë e mundur,  
**që të ndryshojmë sjelljen shkatërruese që shkakton prishjen globale dhe ndryshimin e klimës  
dhe kërcënon çdo formë jete mbi planetin tonë.**

Do të mundohemi t'i konkretizojmë këto angazhime  
**nëpërmjet një sistemi komunikimi në rrjetin mes nesh  
dhe me organizatat ekzistuese që kultivojnë këto interesa  
në kishat e ndryshme dhe në shoqëri.**

Të vëmendshme nga thirrjes që me një zë të vetëm ngrihen nga shumë kultura  
**do t'i përgjigjemi si dishepulle të Jezu Krishtit  
që shohin botën me sytë e zemrës**  
dhe me dhembshurinë e një Hyji që do.

(Mbledhja Plenare e UISG 2001)

## **Pyetje mbi laboratorin**

1. Çfarë nismash janë marrë përpara i përket trafikimit nga Konferenca e Rregulltareve të vendit tuaj?
2. Çfarë nismash specifike janë nxitur nga kongregata juaj dhe nga bashkëpunëtorët tuaj?
3. Si mund të bashkëpunojnë kongregatat mashkullore dhe femërore për të vepruar me solidaritet në favor të viktimave të trafikimit?

SHËNIME